



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

Raport monitorues 18-të

mbi punën e ekzekutivit të komunës

së Lipjanit

Dhjetor 2018

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 3
Përmbledhje ekzekutive,	Faqe 3
Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti,	Faqe 5
Problemet aktuale,	Faqe 6
Transparenca dhe llogaridhënia	Faqe 6
Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit	Faqe 7
Drejtoria e prokurimit	Faqe 11
Arsimi	Faqe 14
Shëndetësia	Faqe 14
Tatimi në pronë	Faqe 16
Burimet:	Faqe 17

Lista e tabelave:

Tabela 1. Shpenzimi i buxhetit në bazë të planifikimit vjetor Janar-Maj 2018	Faqe 7
Tabela 2. Shpenzimi i buxhetit në bazë të alokimit Janar-Maj 2018	Faqe 7
Tabela 3. Planifikimi dhe realizimi i të Hyrave Vetanake 2018- Lipjan Janar-Maj	Faqe 8
Tabela 4. Buxheti komunal 2003/2018	Faqe 9
Tabela 5. Lëndë e ekzekutuara nga Thesari –Ministria e Financave	Faqe 10
Tabela 6. LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUdhës JANAR-QERSHOR 2018	Faqe 12
Tabela 7. Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit	Faqe 14
Tabela 8. Struktura e punëtorëve në QKMF në muajin Maj të vitit 2018	Faqe 15

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Të hyrat komunal nga lloji i burimit	Faqe 9
Grafiku 2. Buxheti komunal 2003/2018	Faqe 10
Grafiku 3. Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Prokurimit	Faqe 12

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2017/2021 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Ekzekutivin dhe Kuvendin e Komunës së Lipjanit.

Raporti të shtatëmbëdhjetë monitorues për punën e ekzekutivit të komunës së Lipjanit, karakterizohet me zhvillime në interes të qytetareve. Me gjithë atë YAHR-i është munduar që të hartojë një raport, duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi e aktiviteteve të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, drejtorive komunale , mbledhjeve të Bordit të Drejtoreve, analizimit të dokumenteve të ndryshme , analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

***Bekim Krasniqi
Drejtor ekzekutiv i YAHR-it***



Hyrje

Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë pjesës së parë të vitit 2018 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.



Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar - Qershor 2018. Monitorimi është fokusuar në punën e ekzekutivit të Komunës, dhe përfshinë fushat: e premtimeve të kryetarit të komunës, transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit urban e ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë. YAHR-i gjatë përpilimit të këtij raporti është bazuar në bazë të informatave të mbledhura në teren nga qytetarët, nga raportet mujore dhe vjetor të kryetarit për vitin

2018, nga monitorimi i drejtpërdrejtë të aktiviteteve të punës së ekzekutivit, nga mediat dhe nga shumë informacione të ndryshme.

Ekzekutivi i Komunës së Lipjanit edhe gjatë kësaj periudhe Janar – Qershor 2018 është përballur me shumë sfida dhe vështirësi. Duke filluar që nga tri problemet kryesore që përballën sot qytetarët e komunës së Lipjanit: Problemin e trajtimit të ujërave të zeza, problemin me furnizim me ujë të pijshëm dhe ndotjen e lumit Sitnica dhe deri tek problemet në mes ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së infrastrukturës, ku kjo e fundit pa pëlqimin e Komunës së Lipjanit i heq tri projekte të planifikuara me buxhet të ministrisë për vitin 2018, si që ishte projektin i rrugës regjional Lipjan-Banullë, Llugë-Radevë dhe të rrugës “Sadik Shala” në Lipjan.

Buxheti i Komunës së Lipjanit në vazhdimësi ka pasur rritje nëpër vite që nga viti 2003 dhe në këtë vit 2018 e kap shifrën e 16,102,983.57 €. Por, shumica e buxhetit shkon në paga dhe mëditje për punëtorët në sferat e administratës komunale, shëndetësisë dhe arsimit.

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën 1 Janar-31 Maj 2018 ka arrit që të shpenzohet në masën 62.97 % ose 5,470,753.39 € nga mjetet e buxhetit të alokuar për këtë periudhë, e cila ishte në vlerën e 8,688,382.04 €. Ndërsa, kemi vetëm 33.97 % të buxhetit të shpenzuar nga buxheti në tërësi për vitin 2018. Kjo shifër është e mirë duke u bazuar në faktin se kemi të bëjë me pesë mujorin e parë të vitit, ku pjesa më e madhe e pritjet të shpenzohen në gjashtë mujorin e fundit të 2018.

Po ashtu vazhdohet me një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës ku deri me 31 Maj 2018 janë realizuar në vlerë 546,153.28 € ose 28.20 % nga planifikimi vjetor buxhetor që është në vlerën e 1,936,600.00 euro për vitin 2018. Krahësuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 kemi 113,724.15 euro të hyra me pakë të realizuara, ku në të njëjtën periudhë të vitit 2017, ishin realizuar 659,877.43 € ose 31.29 % nga buxheti i planifikuar. Realizimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë deri me 31.05.2018, është realizuar në vlerën 234,512.67 € ose 29.31% nga planifikimi i të hyrave për vitin 2018, që është 800,000.00 €. Nëse e bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë me vitin 2017 kemi një ngritje të hyrave nga tatimi në pronë në vlerën 31,482.74 €.

Thesari –Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe ka ekzekutuar 14 lëndë në bazë të vendimeve gjyqësore, pa pëlqimin e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit në favor të individëve dhe subjekteve tjera juridike, ku buxhetit komunal është dëmtuar në vlerën 237,219.77€.

Drejtoria Komunale e Prokurimit në Komunën e Lipjanit, gjatë kësaj periudhe, ka pasur 151 shpallje për tenderim, nga të cilat kemi 111 tenderë janë me vlera të mesme ose 73.50 % prej tyre dhe 3 të ri-tenderuara, ndërsa kemi vetëm 40 shpallje në vlerat të ulta dhe pa asnjë ri-tenderim.

Komuna e Lipjanit ballafaqohet me një gjendje të rënd në sektorin shëndetësor, për kundër angazhimeve të shumta të Drejtorisë Komunal për Shëndetësi, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese, por prapë se prapë gjendja mbetet e rënd, me fajin e Ministrisë së Shëndetësisë. Gjatë kësaj periudhe ka pasur mungesë të gjerave elementare duke filluar nga shiringat, gypin përcjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësorë, fashat, cilindrin mbushës me oksigjen, mungesë të barnave nga lista esenciale dhe plotë gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent.

Po ashtu, probleme ka edhe në sferën e arsimit në Lipjan, në mungesë të infrastrukturës edhe me problemet e numrit të madh të nxënësve nëpër klasa në me shkollat e mesme, ku numri i nxënësve tejkalon mesataren e parashikuar.

Rreth transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale kanë një gatishmëri për bashkëpunim me shoqërinë civile, por duhet punuar edhe më shumë. Gjatë kësaj periudhe kemi nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit në mes të organizatës së shoqërisë civile YAHR dhe kryetarit të Komunës së Lipjanit, Z.Imri Ahmeti,

Profili i Kryetarit Imri Ahmeti

Imri Ahmeti u lind më 05.08.1964, në fshatin Torlnë, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatin Rufc, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës.



Profesor i Lëndëve Juridike në gjimnazin në Lipjan 1994-1999, Shef i Inspektoratit 1999-2000, Shefi i sektorit për regjistrimin e bizneseve 2004-2007, Kryeshef Ekzekutiv 2004-2007, Këshilltar politik në Kabinetin e Presidentit të Kosovës 2007-2008, Këshilltar i lart politik i Zëvendës së kryeministrit të Qeverisë së Kosovës z. Ramë Manaj 2008-2010, zv/ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës 2010, Deputet në Parlamentin e Kosovës 2011-2013, Nga viti 2013 kryetar i Komunës së Lipjanit¹.

Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Imri Ahmeti, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 21 Shtator deri me 20 Tetor 2017, por për shkak të periudhës së shkurtër që nga marrja e mandatit të dytë, nuk e kemi parë të arsyesh dhe të logjikshëm që të bëjmë një vlerësim të tyre . Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne, në mes të tjerash Kryetari Ahmet ka premtuar që ti realizoj këto projekte gjatë vitit 2017-21:

Investimet e planifikuara në qytetin e Lipjanit:

Vazhdimi i ndërtimit të rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit publik në të gjitha lagjet e qytetit (trajtim i veçantë: Lagja e Akllapit dhe Konjuhiti);

Hapja e rrugëve – unazë jashtë qytetit që do ta lidhë pjesën lindore me pjesën perëndimore nëpërmes rrugëve tranzite;

Asfaltimi i rrugës “Sadik Shala” deri në magjistralen Prishtinë-Ferizaj;

Përfundimi i rrugës me katër korsi nga rrethrotullimi tek ETC deri në qytet;

Asfaltimi i rrugës me katër korsi me infrastrukturë përcjellëse (shtigje të biçikletave, shtigje për këmbësorë) nga Lipjani - deri te rrethrotullimi te Banulla;

Ndërtimi i rrethrotullimit në hyrje të Lipjanit afër Qendrës së zjarrfikësve;

¹ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>

Ndërtimi i rrugës përgjatë brezit të hekurudhës ndërmjet magjistrales Prishtinë – Prizren deri te rruga e Glllogvcit;
Ndërtimi i shkollës fillore në qytet;
Ndërtimi i një Qendre Rinore në qytetin e Lipjanit;
Ndërtimi i sallës së sporteve te shkolla “Ismail Luma” në Lipjan;
Ndërtimi i kompleksit sportiv te shkollat e mesme në Lipjan;
Ndërtimi i një fushe të hapur sportive në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan;
Ndërtimi i objektit për aktivitetet e personave me nevoja të veçanta;
Ndërtimi i pjerrinave adekuate për persona me nevoja te veçanta në objektet publike dhe në rrugët e qytetit;
Renovimi i objektit të QKMF-së dhe objekteve përcjellëse;
Rregullimi i parkingjeve dhe menaxhimi i tyre;
Rregullimi i parkingjeve nëntokësore mbrapa komunës dhe rregullimi i hapësirave gjelbëruese.
Ndërtimi dhe gjelbërimi i hapësirave të reja publike dhe mirëmbajtja e tyre;
Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë;
Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit “Sitnica”;
Fasadimi i ndërtesave kolektive në shesh dhe në ndërtesat tjera kolektive të qytetit;
Ndërtimi i objekteve për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së dhe për familjet pa strehë banimi;
Ndërtimi i Objektit të ri të Administratës së Komunës;
Dislokimi dhe ndërtimi i tregut të gjelbërt dhe tregut të kafshëve;
Instalimi i kamerave të sigurisë në rrugët e qytetit dhe instalimi i fibrave optike;
Ndërtimi i objekteve të reja me interes publik në partneritet publikoprivat në pronat komunale si: ndërtimi i qendrës zejtare, ndërtimi i çerdhes për fëmijë, projektimi dhe ndërtimi i ngrohjes qendrore etj.
Projekt i veçantë është ndërtimi i tubacioneve për derdhjen e ujërave të zeza nga rrjetet e kanalizimeve të disa vendbanimeve të komunës së Lipjanit në impiantin regional i cili do të ndërtohet me financim të Bashkimit Evropian.

Konjuh:

Asfaltimi i rrugicave; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik deri në Lipjan; ndërtimi i shtratit të lumit; hapja dhe ndërtimi i rrugës Konjuh - Zona Industriale; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Brus, Hanrovc, Janjevë, Teqe:

Asfaltimi i rrugicave në Janjevë, Teqe dhe Brus; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe mirëmbajtja e tyre; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i qendrës rinore në Janjevë; rikonstruimi i rrugës Janjevë – Hanrovc – Brus; renovimi i QMF-së në Janjevë; ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në partneritet publiko-privat; funksionalizimi i ujësjellësit; ndërtimi i shkollës në Brus; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Akllap:

Vazhdimi i asfaltimit të rrugicave; hapja dhe ndërtimi i rrugës Akllap – Sllovi; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; mirëmbajtja e shtratit të lumit; vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i ujësjellësit; instalimi i ngrohjes qendrore në shkolla; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Sllovi, Smallushë:

Asfaltimi i rrugicave; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik; rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre; salla e sportit në Sllovi; renovimi i shkollës dhe instalimi i ngrohjes qendrore në Smallushë; ndërtimi i shkollës në Sllovi (te shkolla e vjetër); renovimi i AMF-së; ndërtimi i

çerdhes së fëmijëve në partneritet publiko-privat; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Gadime e Epërme, Vrellë, Plitkoviq, Gadime e Ulët, Babush, Gllavicë, Marevc:

Ndërtimi i rrugës së re transit nga rruga regjionale e Gjilanit – Gadime e Epërme deri në magjistralen Prishtinë - Ferizaj me qëllim të shkarkimit të transporteve nga Gadimja e Epërme dhe Gadimja e Ulët; asfaltimi i rrugës Gadime e Epërme –Gllavicë; asfaltimi i rrugës Gadime e Ulët – Babush – Cernillë; asfaltimi i rrugës deri te pishat e Gadimes; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik; vazhdimi i ndërtimit të shtretërve të lumenjve; ndërtimi i objektit të shkollës fillore; ndërtimi i infrastrukturës së shkollave Gadime – Gllavicë – Marevc – Vrellë; ndërtimi i ujësjellësit në Vrellë; ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat; renovimi i sallës së sporteve në Gadime; ndërtimi i fushave të sportit në Gadime dhe Babush; renovimi i AMF-së në Babush; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike.

Llugaxhi, Bujari, Qallapek:

Asfaltimi i rrugicave; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik; rregullimi i shtretërve të lumenjve; ndërtimi i fushave të vogla sportive në Bujari dhe Qallapek; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike.

Banullë, Gllgovc:

Asfaltimi i rrugicave; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik; vazhdimi i rregullimit të shtretërve të lumenjve; ndërtimi i sallës së sporteve; ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat; renovimi i AMF-së; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike.

Përcaktimi dhe zhvillimi i zonës ekonomike për agrobiznes në zonën kadastrale në Banullë.

Rubovc, Kojskë, Pojatë:

Asfaltimi i rrugicave; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; renovimi i AMF-së; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; ndërtimi i rrugës Kojskë – Topliqan; mirëmbajtja e shtratit të lumit “Sitnica”; ndërtimi i fushave të vogla sportive; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.

Topliqan, Grackë e Vogël, Jeta e Re, Grackë e Vjetër:

Asfaltimi i rrugicave; ndërtimi i rrugës Grackë e Vjetër – deri te rruga Lipjan– Kraishtë; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; mirëmbajtja e shtratit të lumit “Sitnica”; ndërtimi i fushave të vogla sportive në Grackë të Vogël dhe Jeta e Re; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i rrugës Topliqan-Kojskë; ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; ndërtimi i AMF-së në Topliqan; rregullimi i infrastrukturës në shkolla.

Hallaq i Madh, Bujan, Bregu i Zi, Varigovc, Kraishtë:

Asfaltimi i rrugicave; asfaltimi i rrugës Hallaq i Madh – Rufc i Ri; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit; renovimi i AMF-së; ndërtimi i fushave sportive në Bujan; Bregu i Zi dhe Varigovc; trajtimi i ujërave të zeza – ndërtimi i rrjetit të kanalizimit nga kolektorët; ndërtimi i shëtitores deri te Kroji i Kraishtës; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Ribar i Madh, Zllakuqan:

Asfaltimi i rrugicave; asfaltimi i rrugës Ribar i Madh – Torinë; asfaltimi i rrugës së varrezave; vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i shtretërve të lumenjve; ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit; ndërtimi i sallës së sporteve në Ribar të Madh; ndërtimi i fushës së sportit në Zllakuqan; ndërtimi i

infrastrukturës së shkollave; investimi në hapësira publike dhe mirëmbajtja e tyre; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Ribar i Vogël, Hallaq i Vogël:

Asfaltimi i rrugicave; asfaltimi i rrugës Ribar i Vogël – Torinë; asfaltimi i rrugës Rufc i Vjetër – Rufc i Ri; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Hallaq të Vogël; ndërtimi i fushës së sportit në Hallaq të Vogël dhe Rufc të Ri; ndërtimi i sallës së sportit në Rufc të Ri; funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; rregullimi i urave mbi shtratin e lumit “Sitnica” në Rufc të Ri dhe Rufc të Vjetër; rregullimi i urës mbi shtratin e lumit “Janjevka”.

Poturovc, Torinë:

Asfaltimi i rrugicave; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; renovimi i shkollës së vjetër në Poturovc; ndërtimi i parqeve dhe hapësirave publike.

Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë, Gllanicë:

Asfaltimi i rrugicave në Dobrajë të Madhe, Llugë, Gllanicë dhe Dobrajë të Vogël; asfaltimi i rrugës Llugë-Radevë; asfaltimi i rrugës Dobrajë e Vogël – Medvec; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Dobrajë të Vogël; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i fushës sportive në Dobrajë të Madhe; Dobrajë të Vogël dhe Gllanicë; renovimi i shkollës dhe infrastrukturës në Dobrajë të Vogël, Llugë dhe Gllanicë; vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit dhe mirëmbajtja; vazhdimi i ndërtimit të stadiumit në Dobrajë të Madhe; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Magure, Qylagë, Vërshevc, Leletiq, Medvec, Vrellë e Magures:

Asfaltimi i rrugicave në të gjitha fshatrat; asfaltimi i rrugës Magure – Dobrajë e Vogël; asfaltimi i rrugës Vershevc-Varrezat e Qylagës; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Vrellë (Harilaq i Vogël); Leletiq dhe Vërshevc; ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Leletiq; ndërtimi i shtretërve të lumenjve; ndërtimi i hapësirave publike; renovimi i QMF-së në Magure; ndërtimi i infrastrukturës së shkollave në Leletiq, Qylagë, Vrellë e Magurës; ndërtimi i fushave të sportit në Leletiq dhe Vrellë; ndërtimi i stadiumit në Magure; ndërtimi i shëtitores në Magure – Kroi Leletiq; ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat në Magure; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e hapësirave publike; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Mirenë, Baincë, Resinoc:

Asfaltimi i rrugicave në Mirenë, Resinoc dhe Baincë; zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik; ndërtimi i fushave të sportit në Resinoc dhe Mirenë; instalimi i ngrohjes qendrore në shkollën e Resinocit; ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Shalë, Krojmir, Kleqkë, Divjakë:

Asfaltimi i rrugicave në Shalë, Krojmir; asfaltimi i rrugës në Divjakë; vazhdimi i ndërtimit të rrugës “Gryka e Shpëtimit”; ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në rrugët kryesore në Shalë dhe Krojmir; ndërtimi i fushave të sportit në Shalë dhe lagjen e Pojatave në Krojmir; funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në Shalë dhe Krojmir; zgjerimi dhe funksionalizimi i rrjetit të kanalizimit në Shalë dhe Krojmir; hapja dhe mirëmbajtja e shtratit të lumit “Drenica”; ndërtimi i shtretërve të lumenjve në pjesët qendrore në fshatrat Shalë dhe Krojmir; renovimi i QMF-së; renovimi i shkollës në Krojmir; ndërtimi i infrastrukturës në shkollën filllore në Shalë; instalimi i ngrohjes qendrore dhe renovimi i shkollës së mesme në Shalë; ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat në Shalë; ndërtimi i AMF-së në Krojmir; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre; mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Problemet aktuale

Sikur se edhe në raportet e kaluara monitoruese Komuna e Lipjanit nuk po arrin kurrë se si ti zgjidhë problemet kryesore që po preokupohen qytetarët e Lipjanit, në këtë nuk e ka pas arritur as ekzekutivi i kaluar, por edhe ekzekutivi tanishëm nuk ka bërë as ndonjë përpjekje serioze në zgjidhjen e tri problemeve kryesore që sot qytetarët e Lipjanit preokupohen dhe ato janë:

- Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre
- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;

Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre: Komuna e Lipjanit është duke u përballur me një problem që dita ditës është duke u zgjeruar, i mos trajtimit të ujërave të zeza. Gjatë viteve të kaluara janë rregulluar një numër i sistemeve të kanalizimeve pa trajtimin e ujërave të zeza, pra pa kolektor, pa impiante për trajtim dhe këto ujëra janë derdhur drejtpërdrejtë në lumin Sitnica apo edhe nëpër fusha dhe livadhe. Këto ujëra të derdhura gjithnjë e më shumë po ndikojnë në ndotjen e ambientit jetësor dhe janë duke ndikuar edhe në shëndetin e qytetarëve.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim , edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2013-ta dhe 2017-tës nga kryetari i komunës Z. Imri Ahmeti.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimin e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Tabela 1. Numri i punëtorve në Komunë E PERGJITHSHME

Viti	Numri totali i stafit	Numri i Stafit që janë gra që janë burra	Numri i stafit	I Paga dhe meditje(shuma per gra)	Paga dhe meditje(shuma per burra)
2013	1484	616	868	4985,480.42	3,438,929.66
2014.	1496	662	834	3,033,368.94	3,869,007.27
2015,	1501	669	832	3,598,793.74	4,512,024.97
2016	1535	768 !	767	4,362,928:78	4,343 695:04

2017	1522	745. [	777	4,152,561.80	4,620,240.20
2018	1522	745	777	4,153,651.70	4,650.220.10
2019	1522	740 !	782	4,143.650.00	5,327,810.00
2020	1522	74.0	, 782	4,143.650.00	5,327,810.00
2021	1522	740	782	4,143.650.00	5,327,810.00

Tabela2. Planifikimi për vitin 2019 Niveli pagave në Komunë

Nivelet pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i ! burra	Shuma e shpenzuar për ! burra	Numri i grave	Shuma shpenzuar gra	e për
202.-400	463	167	1,296,862.82	296	1,307,826,20	
401-600	947	497 ₁	2,819,085.76	450.	3,170,111.00	
600+	112	81	478,613.22	31	398,961.00	

Transparenca dhe llogaridhënia

Rreth transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale në Lipjan kanë një gatishmëri për bashkëpunim me shoqërinë civile, por duhet punuar edhe më shumë. Gjatë kësaj periudhe kemi nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit në mes të organizatës së shoqërisë civile YAHR dhe kryetarit të Komunës së Lipjanit, Z.Imri Ahmeti, ku nëpër mes këtij memorandumi bashkëpunimi formohet edhe një Grup Joformal i quajtur për transparencë i cili do të kontribuonte drejtpërdrejtë në ngritjen e transparencës të institucioneve komunale. Grupi Joformal për transparencë përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve lokale, subjekteve politike, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe mediat lokale.

Zyra Komunale për informimi si përgjegjëse për komunikim me qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile iu është përgjigjur të gjitha kërkesave në mënyrë pozitive, ku gjatë kësaj periudhe ka pasur 22 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare dhe të gjitha kërkesat kanë marrë përgjigje pozitive.

Është duke vazhduar transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit komunal në kanalin Youtube, ku qytetarët mund të përcjellin punimet e Kuvendit Komunal.

Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit

Buxhet i Komunës së Lipjanit në vazhdimësi nëpër vite ka pasur rritje, duke filluar që nga viti 2005, ku ishte 4,528,532.00 € deri në vitin 2018, ku është në vlerën e 16,102,983.57 €. Por, shumica e buxhetit shkon në paga dhe mëditje për punëtorët në sferat e administratës komunale, shëndetësisë dhe arsimit.

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën 1 Janar-31 Maj 2018 ka arrit që të shpenzohet në masën 62.97 % ose 5,470,753.39 € nga buxheti i alokuar për këtë periudhë në vlerën e 8,688,382.04 €. Ndërsa, kemi vetëm 33.97 % të buxhetit të shpenzuar në tërësi. Kjo shifër është e mirë e arritur në

shpenzimin e buxhetit për periudhën pesë mujore në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritët të shpenzohen në gjashtë mujorin e fundit të 2018.

